



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 42, datë 20 .11. 2012

**PËR “DISA NDRYSHIME NË BUXHETIN E BASHKISË SË TIRANËS PËR VITTIN  
2012”**

Në mbështetje të nenit 19, pika 2 dhe 9 dhe nenit 32, gërma “dh” të ligjit nr.8652 datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 44, paragrafi i dytë shkronja “a” e ligjit nr.9936 datë 26.06.2008, për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, pikës 96, shronja “a” dhe 97 të udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.2, datë 06. 02. 2012 për “Proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.25 datë 28.12.2011 për “Miratimin e Buxhetit të vitit 2012” (i ndryshuar), vendimit të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr.8, datë 05.10.2012 “Për disa ndryshime në vendimin nr.4, datë 18.05.2012 të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, për “Shpërndarjen e fondeve të zhvillimit të rajoneve”, shkresës së Administratorit të Përgjithshëm nr.2931, date 31.10.2012, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I**

1. Të miratojë ndryshimet në fondin e investimeve të buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2012, për projektet e miratuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për këtë vit, në programin e Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik dhe në programin e Arsimit Parauniversitar dhe Edukimit, sipas tabelës nr.1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Të miratojë një shtesë në programin e Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik dhe një pakësim në programin e Shërbimeve Publike Vendore, të buxhetit të Bashkisë së Tiranës për projektet e miratuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, sipas tabelës nr.2 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të miratojë ndryshimet në fondin e investimeve të buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2012, nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, brenda programit të Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik, programit të Arsimit Parauniversitar dhe Edukimit, programit të Shërbimeve Publike Vendore dhe programit të Kujdesit Social, sipas tabelës nr.3, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Prokurimeve dhe Drejtoria e Financës, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**Niazi KOSOVRASTI**